



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.



Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Duke u bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjen Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Ligji nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe bazuar në nenin 7 të Statutit të Ndërmarrjes Publike K.R.U “Hidrodrini” Sh.A., Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më 10.07.2026, shqyrtoi Rregulloren për Provizionimin e llogarive të arkëtueshme, dhe lidhur me të njëjtin, njëzëri, mori këtë:

VENDIM NR. 20

- I. Miratohet Rregullorja për Provizionimin e llogarive të Arkëtueshme të K.R.U. “Hidrodrini” Sh.A., Pejë.

ARSYETIM

Bordi i Drejtorëve i K.R.U. “Hidrodrini” Sh.A., Pejë, në mbledhjen e mbajtur më 10.07.2026, shqyrtoi Rregulloren për Provizionimin e llogarive të Arkëtueshme.

Bordi i Drejtorëve miratoi Rregulloren pas shqyrtimit të saj nga Komisioni i Auditimit dhe diskutimit në mbledhjet e Bordit. Gjatë shqyrtimit u vlerësua se rregullorja është përgatitur në zbatim të rekomandimeve të përsëritura të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, me qëllim të rregullimit të mënyrës së njohjes së provizioneve për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Bordi vlerësoi se, pavarësisht ndikimit që provizionet mund të kenë në rezultatin financiar të ndërmarrjes, miratimi i rregullores siguron raportim financiar më të saktë, transparencë dhe pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale.

Për këto arsye, Bordi i Drejtorëve, me votim unanim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve
Qendresa Kukaj – Prelvukaj

Ju dërgohet:

- Bordit të Drejtorëve;
- NjPMNP-së;
- Arkivit.

